



Prishtinë: 29.01.2008

Kodi i ZRRE-së: V_158_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_171_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_171_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Ilaz Maxhuni (shifra e konsumatorit DPR – 32027) nga Vushtrria, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 09.11.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 11.07.2007 lidhur me faturimin pa matje – paushall.

- Me datë 28.12.2005 konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar faturimin paushall para vendosjes së orës nga ana e KEK-ut.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK. CO1. 28.12.2005

- Me datë 31.10.2005 e me nr. 06/600/20.X.05 konsumatori ka nxjerrë një certifikatë nga Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe planifikim hapësinor në Komunën e Vushtrrisë në të cilën certifikatë ceket se i është dëmtuar shtëpia konsumatorit Ilaz Maxhuni në masë prej 100 % gjatë luftës.

Provë: Certifikata e Drejtorisë për urbanizëm, rindërtim dhe planifikim hapësinor në Komunën e Vushtrrisë e datës 31.10.2005

- Me datë 08.02.2006 ekipi i autorizuar i KEK-ut gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kanë dalur në vendin e ngjarjes dhe kanë përpiluar procesverbalin nr. 0007843 në të cilin theksohet se kemi dalur me kërkesën e konsumatorit dhe shihet se shtëpia është e rrënuar.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0007843 i datës 08.02.2006

- Me datë 31.03.2007 Divizioni i Furnizimit departamenti për konsumator ka përgatitur një përgjigje me të cilin njofton konsumatorin se nuk ka bazë për korrigjime. Këtë përgjigje konsumatori nuk e ka pranuar asnjëherë (deklarata e konsumatorit).



- Me datë 09.07.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kanë dalur në vendin e ngjarjes dhe kanë përpiluar procesverbalin nr. 0002928 në të cilin theksohet se konsumatori ka banuar në shtëpinë e Sherif Maxhunit prej datës 17.06.1999 e deri më 28.02.2001 ku edhe faturohet pa matje – paushall.

Provë: Procesverbali nr. 0002928 i datës 09.07.2007

- Konsumatori sërish ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturimin pa matje – paushall.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- Me datë 11.07.2007 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit dhe duke u thirrur në listat e leximit të vjetër.

Provë: Përgjigja e KEK-ut me datë 11.07.2007

- Me datë 09.11.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- Me datë 26.12.2008 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e pranuar pjesërisht ankesën e tij.

Provë: ZRRE/DMK_V_171_12_08

- Me datë 20.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_171_12_08

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_171_12_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Vendimi i DMK-së të ZRRE-së të plotësohet në pikën 2, të përcaktohen afatet kohore:

1. Faturimi për këtë konsumator si konsumator pa matje i kategorisë së parë të bëhet deri në vendosjen e njehsorit nr. 3425772 me datë 22.11.2004.
2. Faturimi pas vendosjes së njehsorit (22.11.2004) të bëhet sipas listave të leximit të njehsorit.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Mitrovicë brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar